

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

“Devasoft” SH. P. K

Republika e Shqipërisë

Sot më datë 22.01.2024 në orën 08:30

Neni 1

Emërtimi – Veprimtaria - Ortakët themelues

Është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **Devasoft** sh.p.k

Ortakët themeluesit janë:

- a) Mendim Paci, shtetase shqiptar, lindur më 08/071983, në Cerjan (Peshkopi), banuese në Rruga Faik Konica nr.8 Lezhe me numër identifikimi I30708005U zotërues i 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 100% (njëqind %) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur ne vlerë monetare në 100.00 (njëqind/00) Lekë.

Neni 2

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushat e:

- a) Projektimi, zbatimi dhe menaxhimi i infrastrukturave cloud për të ofruar zgjidhje të shkallëzueshme, fleksibël dhe të sigurta për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave dixhitale.
- b) DevOps: Zhvillimi dhe zbatimi i praktikave DevOps për të optimizuar bashkëpunimin midis funksioneve të zhvillimit dhe operacioneve, përsheptimin e zhvillimit, ciklet e vendosjes dhe përmirësimin e vazhdueshëm.
- c) Shërbimet në ueb: Dizajni, zhvillimi dhe menaxhimi i shërbimeve të uebit, duke përfshirë faqet e internetit, aplikacionet në ueb dhe integrimet API, për të përmirësuar praninë dixhitale të klientëve.
- d) Siguria kibernetike: Ofrimi i shërbimeve dhe zgjidhjeve për të garantuar sigurinë e sistemeve të informacionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në monitorimin e kërcënimeve, mbrojtjen e të dhënave dhe zbutjen e sulmeve kibernetike.
- e) Monitorimi i Sistemit: Implementimi i sistemeve dhe proceseve për monitorimin në kohë reale të performancës dhe sigurisë së sistemeve të informacionit, me synimin për të siguruar disponueshmëri të vazhdueshme të shërbimit;
- f) Aktivitete të tjera të lejuara nga ligji tregtarë i Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Selia e shoqërisë

Selia e shoqërisë tregtare private **Devasoft sh.p.k** ndodhet në adresën: Rruga "Jordan Misja", Hyrja 1, Apartamenti 5, Zona kadastrale Nr.8330, Nr. i Pasurisë 8/176+1-5, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat, përveçse në rastet kur parashikohet shpërbërja e hershme me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5

Administrimi dhe përfaqësimi.

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj të parashikuara nga ligji dhe statuti.

- a) a) Administratori emërohet Z.Erion Nexha, i lindur më 14.04.1983 në Lushnje banues në Tiranë me numër identifikimi I30414025J, i cili do të ushtrojë këtë funksion deri në 19/01/2029 me përjashtim në rast vdekjes, dorëheqjes ose revokimit ose në rast kur parashikohet ndryshe në statut të themelimit.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i nënshkruar i shoqërisë **Devasoft sh.p.k** do të jetë 100.00 (njqind) Lekë. I cili është i pranuar, miratuar dhe nënshkruar nga ortakët.

Kapitali ndahet në 1 (nje) kuota), të cilat kanë vlera të ndryshme por në asnjë rast vlera nuk mund të jetë më e vogël se një Lekë (1,00) secila.

Kuotat do të jenë në pronësi të anëtarëve sipas ndarjes së mëposhtme:

- a) Mendim Paci, Zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë nominale që përbën 100% njqind %) të kuotës së kapitalit themeltar, e shprehur në vlerë monetare në 100.00 (njqind) Lekë.

Ortakët

Z. Mendim Paci

